



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E FINANCES

Nr. 500 Prot.

Rrogozhinë, më 30/01/2026

PROJEKTVENDIM


**“PËR MIRATIMIN E KALIMIT NË PËRDORIM TË NJË PRONE NË PRONËSI TË
BASHKISË RROGOZHINE NË FAVOR TË SHOQËRISË KF EGNATIA SH.A”**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 54, nenit 58 dhe nenit 59 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat shtetërore”, të ndryshuar, legjislacionit në fuqi për administrimin e pasurive publike të njësive të vetëqeverisjes vendore, Statutit të shoqërisë KF Egnatia sh.a., Relacionit shpjegues dhe Relacionit financiar përkatës.

Duke marrë parasysh se prona objekt i këtij projekt-vendimi është në pronësi të Bashkisë Rrogozhine dhe shoqëria KF Egnatia sh.a. ushtron aktivitet sportiv me interes public, Bashkia Rrogozhine zotëron 25% të aksioneve në shoqërinë KF Egnatia sh.a. dhe kalimi në përdorim i pronës përbën kontribut në natyrë të Bashkisë, pa cënuar pronësinë publike dhe pa krijuar shpenzime buxhetore, për kete arsye I propozojmë Keshillit Bashkiak sa me poshte;

TE VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në përdorim të pronës në pronësi të Bashkisë Rrogozhine e identifikuar me nr. pasurie 134/1 vol.14 fq.151 zk.2399 me sipërfaqe totale Truall 5150 m² dhe S=360 m² Ndertese 1 KT ,me pronar Bashkia Rrogozhine,prone e cila ndodhet ne Njesie Administrative Lekaj,në favor të shoqërisë **KF Egnatia sh.a.**, shoqëri në të cilën Bashkia zotëron 25% të aksioneve
2. Kalimi në përdorim bëhet:
 - Vetëm për qëllime sportive dhe zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë.
 - Pa kalim të së drejtës së pronësisë.
 - Pa të drejtë tjetërsimi apo ndryshimi destinacioni.
 - Për një afat prej 25 (Njëzetë e pesë) vitesh,me te drejte rinovimi.
3. Shoqëria KF Egnatia sh.a. detyrohet:
 - Të përdorë pronën vetëm për qëllimin e përcaktuar në këtë vendim.
 - Të kryejë mirëmbajtjen, administrimin dhe shfrytëzimin e saj me shpenzimet e veta.
 - Të mos kryejë asnjë veprim që cenon pronësinë publike të Bashkisë Rrogozhine.
4. Kalimi në përdorim përbën **kontribut në natyrë** të Bashkisë Rrogozhine në shoqërinë KF Egnatia sh.a. dhe nuk shoqërohet me detyrime financiare shtesë nga buxheti vendor.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Rrogozhine për lidhjen e kontratës së përdorimit dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim strukturave përkatëse të Bashkisë.


KRYETAR
Edison MEMOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E FINANCES

Nr. 500/ Prot.

Rrogozhinë, më 30.01.2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KALIMIT NË PËRDORIM TË NJË PRONE NË PRONËSI TË BASHKISË RROGOZHINË NË FAVOR TË SHOQËRISË KF EGNATIA SH.A”

Në mbështetje të nenit 9, nenit 54, nenit 58 dhe nenit 59 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat shtetërore”, të ndryshuar, legjislacionit në fuqi për administrimin e pasurive publike të njësive të vetëqeverisjes vendore, Statutit të shoqërisë KF Egnatia sh.a., Relacionit shpjegues dhe Relacionit financiar përkatës.

Duke marrë parasysh se prona objekt i këtij projekt-vendimi është në pronësi të Bashkisë Rrogozhine dhe shoqëria KF Egnatia sh.a. ushtron aktivitet sportiv me interes public, Bashkia Rrogozhine zotëron 25% të aksioneve në shoqërinë KF Egnatia sh.a. dhe kalimi në përdorim i pronës përbën kontribut në natyrë të Bashkisë, pa çenuar pronësinë publike dhe pa krijuar shpenzime buxhetore.

I. Qellimi i relacionit

Ky relacion financiar është hartuar për të analizuar ndikimin ekonomik dhe financiar të kalimit në përdorim të një prone në pronësi të Bashkisë Rrogozhine, në favor të shoqërisë KF Egnatia sh.a., shoqëri në të cilën Bashkia Rrogozhine zotëron 25% të aksioneve, bazuar në Raportin e Vlerësimit të pasurisë

II. Baza e vlerësimit financiar

Vlera ekonomike e pronës objekt i këtij propozimi është përcaktuar nga subjekt i licencuar, përmes Raportit të Vlerësimit, i cili përmban:

- përshkrimin teknik të pasurisë
- metodologjinë e përdorur për vlerësim
- vlerën e tregut të pronës

Ky raport shërben si bazë orientuese për vlerësimin financiar të kontributit në natyrë që Bashkia jep në shoqërinë KF Egnatia

III. Forma e kontributit financiar

Kalimi i pronës bëhet:

- Vetem në përdorim
- Pa kalim të drejtës së pronësisë
- Me afat të përcaktuar, me të drejtë rinovimi
- Pa tjetërsim dhe pa krijim të drejtës reale mbi pronën

Ky veprim përbën kontribut në natyrë të Bashkisë Rrogozhine në shoqërinë ku ajo është aksionere me 25% të aksioneve, duke mos përfshirë dalje fondesh nga buxheti vendor.

IV. Efektet financiare për Bashkinë

- Mungese shpenzimesh buxhetore

Kalimi në përdorim i pronës nuk krijon shpenzime direkte financiare për Bashkinë Rrogozhine pasi:

- Prona mbetet në pronësi të Bashkisë Rrogozhine
- Shpenzimet e administrimit dhe mirëmbajtjes i kalojnë shoqërisë KF Egnatia



➤ **Mungesë humbjeje të të ardhurave**

Nga analiza financiare rezulton se prona nuk gjeneron aktualisht të ardhura për Bashkinë. Për rrjedhojë, kalimi në përdorim nuk sjell humbje të ardhurash buxhetore.

➤ **Përfitim financiar indirekt**

Si aksionere, Bashkia përfiton indirekt nga:

- rritja e vlerës ekonomike të shoqërisë
- përmirësimi i infrastrukturës sportive
- ulja e nevojës për subvencione të drejtpërdrejta financiare në të ardhmen.

V. Qëndrueshmëria financiare dhe interes publik

Përdorimi i pronës nga shoqëria KF Egnatia krijon kushte për:

- zhvillimin e aktivitetit sportiv me interes publik.
- rritjen e performancës sportive dhe ekonomike të shoqërisë.
- promovimin e Bashkisë Rrogozhine në nivel kombëtar.

Këto efekte përkthehen në vlerë të shtuar ekonomike dhe sociale, në përputhje me rolin e Bashkisë si aksionere dhe garantuese e interesit publik.

VI. Përfundime

Në përfundim, nga analiza financiare dhe nga të dhënat e Raportit të Vlerësimit rezulton se:

- kalimi në përdorim i pronës nuk cenon buxhetin vendor.
- nuk krijon detyrime financiare shtesë për Bashkinë Rrogozhine.
- përbën një kontribut të arsyeshëm dhe të justifikuar ekonomikisht.
- respekton parimin e menaxhimit të kujdesshëm të pasurive publike.

Ju faleminderit!
Për Drejtorinë e Financës
Drejtori
Rezart VOGLI